


DEMOKRACIA



NË
NDËRTIM

PËRDORIMI I MEDIAS

MENTOR (11), ELITA (11), ANDI (11), EZAN (11), AULONA (11), FJONA (10)



Mendojeni jetën tonë pa media. Si do të ishte ajo?

Ne si njerëz kemi dëshira dhe preferenca të ndryshme. Dikujt i pëlqejnë librat, dikujt i pëlqen futbolli, e dikush tjetër preferon vallëzimin. Mirëpo, jo gjithmonë kemi mundësi të shkojmë dhe t'i ndjekim nga afër ndeshjet e futbollit apo garat e vallëzimit. Fatmirësisht, ekziston media. Përmes medias ne ndjekim ndeshjet e futbollit, informohemi për ngjarjet e fundit, zbavitemi me emisione argëtuese, mësojmë kuriozitete, etj.

Megjithatë, roli i medias është shumë më i gjerë se kaq. E dijme se në demokraci ne si qytetarë luajmë rol vendimmarrës. Por, pa media ne nuk do të ishim të informuar dhe si pasojë nuk do të dinim si të vepronim. Marrim shembull deputetin Laps Lumturia. Ky deputet ishte zgjedhur nga populli. Mirëpo, ai nuk i

kishte kryer detyrat e tij si deputet. Këtu hyri media. Televizione dhe gazeta të ndryshme njoftuan qytetarët për faktin se deputeti Laps Lumturia nuk po tregohej përfaqësues shumë i mirë. Në këtë mënyrë, në zgjedhjet e ardhshme qytetarët nuk e votuan këtë deputet. Për këtë arsye media njihet si Pushteti i Katërt. Ajo ka vlerë shumë të madhe në jetën tonë. Pa të, do të ishim në errësirë të plotë, kur është fjala për informata. Theksojmë se kemi dy lloje të medias. Media elektronike ku hyjnë: televizori, telefoni, radio, kompjuteri, etj. Si dhe kemi media të shkruara, ku bëjnë pjesë: librat, fletushkat, revistat, gazetata, etj.


Ne sot e kuptuam rëndësinë e medias në jetën tonë. Gjithashtu, kuptojeni edhe ju se duhet të jemi të kujdesshëm se nga cilat media informohemi.



Ne jemi autorët e këtij artikulli. Sot u bëmë gazetarë për herë të parë dhe me shumë entuziazëm e përfunduam detyrën tonë

TË PUNOJMË PËR TË MIRËN E VENDIT TONË

DIBRAN (11), BAHRI (11), MELISA (10), FURKAN (10), ALBIJONA (10), FLONART (10)



Në demokraci, të gjithë qytetarët duhet të ndihmojnë në mirëmbajtjen e shtetit të tyre

Sot u bëmë pjesë e projektit „Demos-ti“. Qëllimi i pjesëmarrjes sonë në këtë projekt është të mësojmë për demokracinë dhe të mësojmë se si të bëhemi qytetarë aktiv.

Së pari, po fillojmë me shpjegimin e fjalës qytetar. Çdo person i cili posedon një dokument si dëshmi që ai/ajo i takon një shteti të caktuar quhet qytetar i atij shteti. Qytetari demokratik ka shumë të drejta të cilat mund t'i shfrytëzoj, por pa u penguar të tjerëve. Bashkë me të drejtat shkojnë edhe përgjegjësitë, e që duhet të kryhen nga vetë ne. Nëse ne jemi qytetarë të mirë, atëherë ne mund të ndihmojmë shumë në komunitetin tonë dhe kudo që jemi. Këtë mund ta bëjmë duke bërë punë vullnetare, duke votuar, duke e pastruar ambientin, etj. Kjo është ajo që na bën neve qytetarë aktiv. Edhe ne nxënësit e shkollës „Dardania“, konsiderohemi qytetarë aktiv. Shpeshherë organizohemi me shokët e shoqet dhe bashkë me ndihmësit teknik të shkollës pastrojmë oborrin e shkollës sonë, si dhe qytetin. Përveç kësaj, ne i ndihmojmë edhe personat në nevojë, sepse dëshira jonë është që t'i shohim edhe ata të buzëqeshur.

Sot përveç se mësuam më shumë për demokracinë dhe qytetarinë aktive, ne gjithashtu patëm rastin që të bëjmë vizatime që lidhen me temat në fjalë.

I kemi disa fjalë për ju të cilët po e lexoni gazetën po-

thuajse të përditshme „Demos-ti“: secili prej jush, me veprime të vogla mund të ndihmoj në komunitet, dhe kjo jo vetëm që iu bën juve të ndiheni mirë, por mbi të gjitha iu bën qytetarë aktiv.



Ne kujdesemi për ambientin që na rrethon



Jemi qytetarë aktiv

DEPUTETËT E VEGJËL

RINESA (10), ERDETA (10), LAURA (11), TAHIR (10), DRILONI (11), ALBERTI (10), ELZA (11)



Shtëpia ime, juaja dhe e të gjithë neve

Ne jemi shumë të gëzuar që sot jemi të pranishëm në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“. Gjatë kësaj Punëtorie ne kemi mësuar për Kuvendin.

Jeni kurreshtarë të dini çfarë mësuan?

Ne kemi mësuar për Kuvendin e Kosovës. Kuvendi ndryshe njihet si Parlament. Në Parlamentin e Kosovës janë 120 deputetë. 100 prej tyre janë shqiptarë, 10 janë serbë, kurse 10 të tjerë janë nga komunitetet e tjera jo shumicë. Qytetarët e Kosovës edhe pse kanë etni të ndryshme si: serbë, boshnjakë, turq, romë, ashkali, egjiptianë dhe goranë, ata janë kosovarë. Kjo sepse, ata të gjithë kanë shtetësi kosovare dhe janë pjesë e pandashme e shtetit tonë.

Demokracia është udhëheqje e popullit. Ajo ka dy fjalë greke, njëra është „demos“ kurse tjetra është „kratos“. Kjo do të thotë se në demokraci ka liri dhe të drejta të barabarta për të gjithë ne. Ne thamë se në Kuvend kemi 120 deputetë. Këta ndryshe quhen përfaqësues të popullit. Gjithashtu, ne kemi një Kryetar të Kuvendit, një President, një Kryeministër e disa ministra. Personat që i gëzojnë këto role shumë të rëndësishme zgjedhen nga deputetët e Kuvendit.

Kur jemi tek zgjedhjet duhet të përmendim se ne të gjithë duhet të dijmë kë të zgjedhim si deputet/e. Pra, ne duhet të kemi arritur moshën 18 vjeçare në mënyrë që të marrim pjesë në zgjedhje. Po ashtu, kandidati i cili kërkon votat tona duhet të jetë i besueshëm dhe i sjellshëm me të gjithë ne. Këto zgjedhje për deputetë quhen zgjedhje qendrore ose parlamentare. Zgjedhjet

e tilla janë shumë të rëndësishme për jetën tonë.

Tani do të flasim për funksionet e Kuvendit të Kosovës. Kuvendi ka tri funksione kryesore. Funksioni i parë është funksioni përfaqësues. Ky funksion do të thotë se deputetët për 4 vjet me radhë na përfaqësojnë neve, popullin e Kosovës.

Funksioni i dytë është funksioni ligjvënës, i cili ndryshe quhet funksioni legjislativ. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se deputetët e kanë për detyrë të sjellin ligje të reja. Ligjet e reja miratohen gjithmonë gjatë seancave plenare. Ato janë rregulla të cilat duhet t'i respektojmë të gjithë ne. Qëllimi i tyre është rregullimi i jetës sonë. Kur kemi folur për ligjet, na erdhën në mendje rregullat që i kemi në shtëpi, në shkollë, etj. Se cilat janë disa nga këto rregulla dhe cili është funksioni i tretë i Kuvendit, do të keni rastin të lexoni në faqen e radhës.




Gazetarët nr. 1 të Kosovës!

Puna jonë nuk përfundon këtu. Nëse dëshironi të mësoni më shumë, vetëm vazhdoni leximin



Ja se si do të dukem unë në të ardhmen



Voto, atëherë kur ti të kesh arritur moshën e duhur


Disa prej rregullave që kemi në shtëpi janë: të pastrojmë shtratin, t'i mbledhim lodrat pasi të luajmë, t'i dërgojmë enët tek kuzhina për t'u pastruar pasi të përfundojmë ushqimin. Kurse, në shkollë kemi rregullë që të mos vrapojmë, të mos bëjmë zhurmë gjatë orëve mësimore, të mos ngacmohemi me njëri-tjetrin, etj. Ndër të tjerash, funksioni i tretë i Kuvendit është funksioni kontrollues, i cili do të thotë se deputetët do të shikojnë nëse Kryeministri dhe ministrat i kanë bërë detyrat e tyre mirë dhe se sa i kanë zbatuar ata ligjet. Në vazhdim dëshirojmë të ndajmë me juve dëshirat tona. Ne në grupin punues u përgjigjëm në pyetjen: Çfarë do të bëja, nëse unë do të isha deputet/e në Kuvendin e Republikës së Kosovës?

Unë Erdeta nëse do të isha deputete do të kujdesesha për atdheun tim, duke pastruar fillimisht Prishtinën e më pas të gjitha qytetet e fshatrat e tjera të Kosovës. Unë Tahiri do të vendosja filterët në tymtarët e termocentraleve të Obiliqit për të parandaluar tymin e ndotur. Gjithashtu, do të ndërtoja shkolla të reja, par-

qe me lule të mbjellura, do të ndërtoja shtëpi për të varfërit, do të rregulloja rrugët për makina. Kurse, në shkolla do të sillja fletore, lapsa, goma dhe pajisje të tjera që nevojiten për mësim. Këto gjëra do t'i bëja në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe me qytetarët e Kosovës.

Ndërsa, unë jam Alberti. Nëse unë do të isha deputet i Kuvendit do të kujdesesha për të gjithë qytetarët, pa i dalluar ata në mes vete. Kështu unë do të isha një deputet shumë i mirë. Po ashtu, do të formoja raporte shumë të mira me Kryeministrin, ministrat, Presidentin, etj. Kjo për shkak se për të ndërtuar shtetin tonë duhet të bashkëpunojmë sa më shumë me njëri-tjetrin.

Unë jam Elza. Si përfaqësuese e qytetarëve do të takohesha me ta për t'i kuptuar dëshirat, shqetësimet dhe nevojat e tyre. Pastaj, do të përpiqesha të rregulloja problemet e tyre. Qytetarët e Kosovës më kanë votuar mua, prandaj unë duhet të punoj për ta. Faleminderit për vëmendjen tuaj!



Mësoni për demokracinë, nga librat ose edhe nga ne



Cila iu pëlqen më shumë juve?



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dardania“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Pejë